



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



PLANI STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT PËR GJYKATËN E SHKALLËS
SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN PËR PERIUDHËN DHJETOR
2023- SHTATOR 2024.

I. HYRJE

Në vijim të zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020, në zbatim të Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, në zbatim të nenit 91 të tij Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan vijoje punën për realizimin e objektivave që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka raportuar paraprakisht për realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Komunikimit për Gjykatat, përkatësisht në Raportin Nr. 1. në Raportin Nr. 2., në Raportin Nr. 3., i cila nisi zbatimin në Mars të vitit 2023.

Në vijim sjellim Raportin Nr.4., të ndarë në periudha mbi veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në funksion të realizimit të detyrave të Përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit në përputhje me realizimin e objektivave të Planit të Veprimit për periudhën e mbetur **Dhjetor 2023- Shtator 2024.**

Ky raport u mendua fillimisht të përcillet në mbyllje të vitit kalendarik, për të mos rënë në përsiatje dhe në mënyrë që të përcillej një raportim i plotë nëpërmjet një relacioni përmbledhës për realizimet dhe arsyet objektive të mosrealizimit të disa prej pikave të Planit të Veprimit.

Do të vijojmë me prezantimin përmbledhës për gjithë periudhën 01.12.2024-30.09.2024, në fund të tremujorit të fundit të vitit 2024 do të përcillet raporti për periudhën Shtator- Dhjetor

2024, për të cilin është ngritur grupi i punës i koordinuar nga Zv/ Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Artur Prenga dhe Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka, për caktimin e detyrave dhe vijimin e realizimit të pikave të Planit të Veprimit për periudhën e mbetur.

II. RAPORTI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE TË PLANIT STRATEGJIK TË KOMUNIKIMIT PËR SISTEMIN GJYQËSOR NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN PËR PERIUDHËN 01.12.2023- 31.03.2024.

A. Në zbatim të objektivit nr.1, i cili parashtrohet nevojën për informimin e publikut, të objektivit nr. 2, i cili synon: identifikimin, promovimin, informimin dhe rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë, mes grupeve të interesit dhe gjykatave dhe të përshtatjes së formës tradicionale të komunikimit të gjykatave me teknologjinë e re, për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut dhe nevojave të tyre për një komunikim interaktiv, të shpejtë, efikas dhe cilësor dhe në përshtatje dhe të objektivit nr.3, i cili synon informimin e publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë këto hapa:

1. Në funksion të transparencës dhe me qëllim lehtësimin e procedurës së marrjes së informacionit nga palët e interesit për kalendarin e çështjeve të seancave gjyqësore të javës, publikohen listat e gjykimeve të përditësuara çdo javë në faqen zyrtare në rubrikën **Njoftime** sipas relatorëve të çështjeve. Kjo lidhje u njoftohet çdo të premte publikut në rrjetin social facebook për aksesim të drejtëpërdrejtë të çështjeve për gjykim, por me qëllimin e njohjes dhe promovimit tek publiku të faqes zyrtare të gjykatave www.gjykata.gov.al
2. Publikohet në mënyrë periodike informacioni me tekstin:
 - *Njoftim- Informues për palët e interesit mbi "Rubrikat Njoftuese" të Web-Faqes zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan www.gjykataelbasan.gov.al :*
 - *Njoftimet për "Shpalljet Publike" për palët në proces gjyqësor i gjeni në rubrikën "SHPALLJE PUBLIKE" me emrin e të paditurit të palëve në proces gjyqësor, në lidhjen si në vijim:
<https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e.../shpallje-publike/>*
 - *Njoftimet me "Shpallje Publike" për njoftimet e debitorëve nga Zyrat e Përmbarrimit, i gjeni me emrin e Zyrës së Përmbarrimit në rubrikën e "NJOFTIME TË TJERA", në përmbajtje emri i debitorit, në lidhjen si në vijim:
<https://gjykata.gov.al/.../gjykat.../njoftime-t%C3%AB-tjera/>*

- Njoftimet për çështjet në gjykim të javës publikohen në rubrikën "NJOFTIME", të përcaktuara me periudha dhe Relatorët e çështjeve, të publikuara në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e-shkall%C3.../njoftime/>
- Pasqyra e shtypit publikohet në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e.../pasqyra-e-shtypit/>
- Informacion mbi Shortin publikohet në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjyka.../informacion-mbi-shortin/>
Informacion për Vendet Vakante i gjeni të afishuara në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e.../vende-vakante/>
- Formularin (FEA) për plotësimin elektronik të kërkesave e gjeni në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e.../formular-aplikimi/>
- Kërkesat për informacion dërgohen në postën elektronike zyrtare manjola.kume@gjykata.gov.al duke iu përmbajtur rregullores të cilën e gjeni të publikuar në lidhjen si në vijim: <https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e.../na-kontaktoni/>

Për të siguruar informacion të thjeshtuar dhe orientuar mbi rubrikat e faqes zyrtare të gjykatës për marrjen e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe në çdo kohë nga publiku në rrjete sociale dhe përdoruesit e platformave elektronike.

3. Ekspozimi dhe publikimi i broshurave informuese, i kodit QR dhe Logos së Gjykatës në ambjentet e pritjes së publikut në gjykatë.
4. Publikimi i materialit informues në formë broshure në rrjetin social facebook dhe në rubrikën **Njoftime për Publikun** në faqen zyrtare më datë 10.12.2023 me titull: 10 Dhjetor Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, në kujtesë të aktit juridik të 10 dhjetor të vitit 1948, datë në të cilën Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut.
5. Publikimi i Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median" në rubrikën **Njoftime për Publikun** në faqen zyrtare më datë 21.12.2023.
6. Mbajtja e korrespondencës active, të vazhdueshme dhe përcjellja e informacionit me karakter publik ose specifik që lidhet me çështjet në gjykim, në bazë të kërkesës së depozituar në e-mailin zyrtar manjola.kume@gjykata.gov.al me publikun dhe palët në proces, kërkesa të cilat ezaurohen me kthim përgjigje kryesisht brenda ditës së dërgimit të kërkesës dhe përgjithësisht për kërkesa që kërkojnë një kohë të caktuar për përpunim, gjithnjë brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
7. Përditësimi dhe publikimi i kontakteve, hartimi dhe publikimi i rregullores së dërgimit të kërkesave për informacion publikuar në rubrikën **Na Kontaktoni** në lidhjen si në vijim <https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/na-kontaktoni/>.

8. Në kuadër të transparencës për vitin 2024, është ndryshuar formati i publikimit të regjistrit të kërkesave, i cili është plotësuar dhe publikuar në përputhje me formatin e përcaktuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, me objektin e kërkesës dhe përgjigjen, në lidhjen si në vijim publikuar me titullin: Regjistri i Kërkesave – Ankesave viti 2024 <https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/programi-i-transparences/njoftime-te-tjera/> .
Theksojmë se në këtë regjistër janë publikuar përgjigjet e kërkesave me karakter public ose të mediave, pa bërë pjesë kërkesat e vazhdueshme ditore të paraqitura për shtyrje seance gjyqësore, kërkesa për informacion mbi çështjet, planifikimet, depozitim aktesh etj, për të cilat palët dhe gjykata informohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nëpërmjet identifikimit të tyre dhe korrespondencës së mbajtur në e-mail. Ky regjistër përditësohet në të njëjtin format në mënyrë periodike.
9. Në vazhden e publikimeve të kryera në vitin 2023 në lidhje me informacione mbi gjykatën, të drejtat e njeriut dhe personave me aftësi të kufizuara, është vijuar me hartimin dhe publikimin më datë 23.02.2024 në rubrikën **Njoftime për Publikun** dhe në rrjetin social, i materialit informues mbi “Konceptin e të Drejtave të Njeriut”, materiali u punua duke iu referuar: Nenit 27 i (Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike): tekset e mirënjohura të: Luan Omari, Aurela Anastasi – E drejta kushtetuese; Luan Omari- Shteti i së drejtës; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), 3 shtator 1953. Kristaq Kraja- Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, Konferencën e OKB-së 1993 në Vjenë mbi të Drejtat e Njeriut etj. Materialet publikohen për t’i ardhur në ndihmë nxënësve, studentëve të drejtësisë dhe palëve të tjera të interesit për informacion të përgjithshëm mbi këto të drejta.
10. Është krijuar tradita e njoftimeve për shtyp në rubrikën **Pasqyra e Shtypit**, nëpërmjet publikimit të shkurtimit të vendimeve për çështje me interes të lartë publik. Synojmë në vijim, që të mundësojmë publikimin e një numri më të lartë të përmbledhjeve të vendimeve të shkurtura në bashkëpunim me gjyqtarët e çështjeve dhe sekretarët gjyqësore.
11. Në kuadër të transparencës publikohen rregullisht shpalljet për njoftimet e vendeve vakante, si edhe vendimet për nëpunësit fitues në rubrikën **Vende Vakante**, si edhe në rrjetin social.
12. Në kuadër të **Ditës Ndërombëtare të Gruas, 8 Mars**, u publikua artikulli me të njëjtin titull në rubrikën **Pasqyra e Shtypit**, në kujtesë të simbolikës së kësaj dite dhe në nderim të figurave të rëndësishme të Grave Shqiptare dhe Grave Shqiptare në Drejtësi, në shenjë falenderimi për kontributin e tyre në shoqëri, si edhe mirënjohje për punën e të gjithë Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si edhe punës së vazhdueshme të administratës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të cilat janë një mekanizëm i domosdoshëm për ecurinë dhe mbarëvajtjen e punës në gjykatë.

13. Në kuadër të plotësimit të kërkesave të Ligj nr.9877, datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, si dhe në mbështetje të nenit 4 të Ligj Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” dhe Urdhërit Nr.14 dt.22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u konceptuan materialet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit për Programin e Transparencës, në funksion të orientimit dhe informimit të publikut dhe në përputhje me detyrat e caktuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Programi u miratua nga Zv/Kryetarja znj. Matilda Fetau me urdhër Nr. 158 Prot., më datë 24.01.2024. Programi është në përditësim të vazhdueshëm, në përshtatje të ndryshimeve të herëpashershme. Pas miratimit të tij u vendosën në dispozicion në verison *hard copy* materialet e Programit të Transparencës në sektorët përkatës për zbatim.

B. Në zbatim të objektivit nr.4, i cili synon informimin e publikut, veçanërisht të grupeve në nevojë dhe të miturve, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka ndërmarrë këto hapa zbatimi:

1. Në datë 22.12.2024, në kujtesë të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut u organizua aktiviteti me titull: **Gjyq Imitues, 75 Vjetori i “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut”**, në të cilën u angazhuan nxënës të shkollës së mesme jopublike Medrese Liria, të cilët në bashkëpunim me gjykatën, përshtatën aktivitetin në të gjithë komponentët e nevojshëm për ndërtimin e një seance gjyqësore e cila u regjistrua me pasazhe të shkurtra për publikim. Publikimi dhe përmbajtja e aktivitetit është publikuar me të njëjtin titull në faqen zyrtare në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** më datë 22.12.2023 dhe në rrjetet sociale të gjykatës.

C. Në zbatim të objektivit Nr:5 i cili synon përforcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, në periudhën shtator-nëntor 2023 janë ndërmarrë këto hapa verpimi:

1. Në kuadër të informimit të publikut kemi publikuar përmbledhje të raporteve statistikore me objekt “Dhuna në Familje dhe Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje”, të cilat tërhoqën vëmendjen e mediave duke drejtuar kërkesë për dhënien e intervistës nga Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka nga ABC NEWS dhe VIZION PLUS. Intervista u publikua në rrjetet sociale më datë 02.02.2024, si dhe u dokumentua me artikullin e publikuar në 12.02.2024 në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** me titull “Dhuna në Familje dhe Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje për vitet 2022-2023”.

D. Në zbatim të objektivit nr: 6, i cili ka për synim afrimin e komunitetit me gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjësuese si dhe bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional mes grupeve të interesit Gjykata e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë këto hapa veprimi:

1. Në kuadër të ndërveprimit ndërinstitucional më datë 09.01.2024 me ftesë të Shkollës së Magjistraturës u mirëprit dhe u organizua nga gjykata takimi me tematikë **“Efektiviteti i Programve të Trajnimit për Gjyqtarët dhe Prokurororët nga Shkolla e Magjistraturës”**. Në këtë takim ishin të ftuar:
 - Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Kreshnik Ajazi;
 - Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë z. Ervin Sulaj;
 - Z. Sokol Berberi- Përgjegjës i Programit të Formimit Fillestar dhe Përgjegjës i lëndës së Shkrimit dhe Arsytimit Ligjor në Shkollën e Magjistraturës;
 - Z. Vangjel Kosta Pedagog, Lektor në Shkolla e Magjistraturës
 - Trupa Gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.Përmbajtja e zhvillimit të aktivitetit u dokumentua dhe publikua më datë 09.01.2024 në rubrikën **Pasqyra e Shytpit** me të njëjtin titull.
2. Më datë 07.03.2024, në kuadër të bashkëveprimit ndërinstitucional, me kërkesë të ekspertit të lartë ligjor z. Arben Lila në projektin EU4Justice- projekt i Bashkimit European në mbështetje të institucioneve të pavarura të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjykata organizoi takimit me tematikë **“Zbatimin i Hartës së Re Gjyqësore”**. Zhvillimi i takimi të organizuar dhe të mbajtur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u dokumentua në artikullin e publikuar në faqen zyrtare në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** dhe në rrjetet sociale më datë 13.03.2024 me tittull: **Takimi Eu4justice me Tematikë “Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore”**.
3. Më datë 21.03.2024, në sallën e mbledhjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, u realizua tryeza e takimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, në të cilën u referua mbi **Anilazën Vjetore** të veprimtarisë së Gjykatës për Vitin 2023. Në këtë takim ishin të ftuar:
 - Zv/ Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi,
 - Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Kreshnik Ajazi,
 - Zv/ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan z. Xheljan Seferi,
 - Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan z. Ilir Proda,
 - Shefi i Komisariatit të Policisë Vendore Elbasan, Komisar z. Roven Zeka,
 - Drejtuesi i Dhomës së Avokatisë Elbasan z. Demir Çiftja në cilësinë e përfaqësuesit të zërit të qytetarëve të Elbasanit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre,

-Trupa Gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Zhvillimi i takimit u dokumentua në artikullin e publikuar më datë 29.03.2024 në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** me titull: **Tryezë Takimi "Analiza Vjetore 2023" e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.**

4. Më datë 25.04.2024, Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. Matilda Fetau mirëpriti në një tryezë takimi sëbashku me gjyqtarë të Trupës Gjyqësore të Gjykatës znj. Aurora Alimadhi, z. Elis Dine, znj. Ina Yzellari, Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan z. Ilir Proda, Shefin e Komisarariatit të Policisë Elbasan z. Roven Zeka, Shefin e Komisarariatit Peqin z. Pellumb Kovashica, Shefin e Komisarariatit Librazhd z. Petrit Hala, Shefin e Komisarariatit Gramsh z. Krenar Guçe, Shefin e Komisarariatit Cërrik z. Islam Haka, Zv. Drejtorin për Sigurinë Publike z. Besnik Kongjonaj. Objekti diskutimit të tryezës së takimit ishte rritja e ndërveprimit institucional në funksion të mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore. Takimi u dokumentua në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** publikuar më datë 26.04.2024 me titull: **Takimi me Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.** Në sajë të këtij takimi, u bë i mundur ndërveprimi mes institucioneve dhe u vendosën pikat e kontaktit të adresave zyrtare elektronike të Komisariateve të Policisë së Drejtorisë Vendore Elbasan, me adresën zyrtare të Gjykatës manjola.kume@gjykata.gov.al duke siguruar kështu efencë dhe ndërveprim të shpejtë në përcjelljen e shkresave me urdhër të gjyqtarëve.
5. Më datë 21.06.2024, Zv/Kryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. Matilda Fetau mirëpriti në takim Shefin e Policisë së Burgjeve z. Vladimir Skenderi dhe Drejtorin e “Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan” z. Altin Ago. Takimit u relaizua me synim rritjen e ndërveprimit institucional në funksion të mbarëvajtjes së proceseve gjyqësore. Takimi u organizua nga gjykata me kërkesë të Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan z. Altin Ago. Në këtë takim u diskutua për mbarëvajtjen e procesit të punës në lidhje me menaxhimin e vështirësive të mundshe për shoqërimin e të paraburgosurve në proceset gjyqësore, si edhe problematikat e hasura mbi Urdhërat për Shoqërimin e të Burgosurve në Gjykatë. Takimi u publikua në rrjetin social Facebook.
6. Më datë 25.06.2024, me ftesë të **Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit** gjykata organizoi seminarin me Trupën Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mbështetje të Indikatorit 7-të të SBS-së së **“#BE për Reformën në Drejtësi”** dhe Strategjitë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit për vitet 2021-2025. Tematika e seminarit ishte “Sistemi i Ndërmjetësimit dhe Mekanizmi i Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim” dhe prezantimi i modelit të formularit referues”. Në takim ishin të ftuar:
-Zv/Ministri i Drejtësisë z. Tedi Dobi;
-Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. Florjan Kalaja;

-Dretjori i Përgjithshëm i Profesioneve të Lira dhe Ekstradimeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë znj. Flora Dedgjonaj.

Kjo tryezë takimi u realizua me ftesë të Kryetares së Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit znj. Drita Avdyli në kuadër të Projektit Pilot të implementimit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim në të cilën është përzgjedhur për pilotim të projektit edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Aktiviteti u dokumentua në rrjetin social Facebook më datë 26.06.2024.

III. RAPORTIMI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE TË PLANIT STRATEGJIK TË KOMUNIKIMIT PËR SISTEMIN GJYQËSOR NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN PËR PERIUDHËN 01.04.2024 – 30.09.2024.

A. Në zbatim të objektivit nr.1, i cili parashtrohet nevojën për informimin e publikut, të objektivit nr. 2, i cili synon: identifikimin, promovimin, informimin dhe rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë, mes grupeve të interesit dhe gjykatave dhe të përshtatjes së formës tradicionale të komunikimit të gjykatave me teknologjinë e re, për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut dhe nevojave të tyre për një komunikim interaktiv, të shpejtë, efikas dhe cilësor dhe në përshtatje dhe të objektivit nr.3, i cili synon informimin e publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë këto hapa:

1. U publikua Programi i Transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 26.04.2024, si edhe u morën masa për publikimin e materialeve sipas rubrikave të posaçme të programit në faqen zyrtare të gjykatës.
2. Në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë më datë 09.05.2024, publikuam në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** një material të shkurtër me përmbledhje të aktiviteteve më të rëndësishme të realizuara në vitin 2023, si edhe titujve të materialeve informuese të publikuara gjatë vitit 2023, të realizuara në zbatim të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit. Këtë material me titull: “Java e drejtësisë” 111 Vjet!, e përshtatëm " e përshtatëm dhe në një video të shkurtër prezantuese të publikuar në rrjetin social më datë 09.05.2024 me titull: “Një vit në prezantim”.
3. Publikimi në faqen zyrtare në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** më datë 02.05.2024 I “Formulari Tip i Ankesës për Nëpunësin Civil Gjyqësor. Miratuar me Vendim Nr. 884 Prot. të Keshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 30.04.2024.
4. Në datë 04.06.2024 publikuam në faqen zyrtare në rubrikën Pasqyra e Shtypit dhe vendosëm në dispozicion të medias **Statistika për të Dënuar të Mitur, vitet 2022-**

2023. Ky artikull tërhoqi vëmëndjen e medias e cila u drejtua me kërkesë për realizimin e një interviste në lidhje me këtë objekt.

5. Është krijuar tradita e ndërveprimit me korrespondencë elektronike të përditëshme duke krijuar akses më të shpejtë me institucionet me të cilat ndërveprojmë për njoftimet e seancave gjyqësore në lidhje me kërksat për shoqërim të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Komisaritet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan por dhe më gjerë. Korrespondencën e njoftimeve për seancat gjyqësore për Zyrat e Shërbimeve Sociale të Bashkive të Rrethit Elbasan si edhe dërgimi i fletët-thirrjeve palëve në proces nëpërmjet postës elektronike zyrtare të gjykatës etj.
6. Është realizuar matja e numrit të shikimeve, pëlqimeve, shpërndarjeve, komenteve të materialeve të publikuara për periudhën Dhjetor 2023- Gusht 2024, e cila monitorohet nëpërmjet opsioneve të menaxhimit që vetë platformat e rrjeteve sociale ofrojnë dhe rezulton se numrin më të lartë dhe aktiv të ndjekësve e kemi ende në adresat tona në Facebook. Profili “**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**”

<https://www.facebook.com/gjykataelbasan.gov.al> është rritur me **631** (gjashtëqind e tridhjetë e një) ndjekës dhe profili “**Zmp Gjykata e Rrethit Elbasan**” <https://www.facebook.com/gjykata.elbasan/> është rritur me **1192** (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) ndjekës, duke shënuar një rritje të konsiderueshme me afërsisht dyfishin e ndjekësve në këtë vit. Rol në rritjen e ndjekësve ka luajtur ndërveprimi mes institucioneve dhe grupeve të interesit në publikimin e aktiviteteve të gjykatës si edhe informacioni i vazhdueshëm i ofruar për publikun. Azhornimi me postime ka qenë i vazhdueshëm me materiale bazuar mbi objektivat e Planit Strategjik të Komunikimit, të cilat gjithashtu publikohen dhe në faqen zyrtare të gjykatës, në mënyrë që informacioni të ketë një shtrihe dhe shpërndarje me akses sa më të gjërë. Rezulton të kenë arritur shikueshmërinë më të lartë deri tani, intervistat e gjyqtarëve **z. Ardit Kuka për Abc News dhe z. Artur Prenga të dhënë për Top Channel** të publikuara në rrjetin social Facebook **me mbi 1000 shikime secila**. Audienca e rrjetit social rezulton se është në përqindje lehtësisht më të madhe me ndjekës femra, e përcjellë në %, rezulton se jemi në raportet 54.50 % ndjekës femra dhe 45.50% ndjekës meshkuj. Moshë e ndjekësve dominonhet nga target grupi i moshës 25-44 vjeç. Përsa i përket pozitës gjeografike një numër i lartë ndjekësve janë kryesisht nga rrethet: Tiranë, Elbasan, Durrës.

B. *Në zbatim të objektivit nr.4, i cili synon informimin e publikut, veçanërisht të grupeve në nevojë dhe të miturve, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka ndërmarrë këto hapa zbatimi:*

1. Në kuadër të **Ditës Kombëtare të Drejtësisë 10 Maj**, u realizua aktiviteti për “Javën e Drejtësisë” më datë 08.05.2024, në të cilën Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka dhe Gjyqtari z. Gjergji Baçi zhvilluan takime me nxënës, mësues dhe drejtues të

Gjimnazit “Dhaskal Todri” Elbasan dhe Gjimnazit “Ibrahim Muça” Librazhd. Në takim u referua për:

- 10 Maj “Dita e Drejtësisë”,
- Prezantim i përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri;
- Parimet kryesore që lidhen me Pushtetin Gjyqësor; Përbërja dhe organizimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- Informimi elektronik nëpërmjet website zyrtar të gjykatës;
- Giovanni Falcone një hero i vetmuar (1939-1992);
- Momentum në karrierën e Giovanni Falcone: Maksiprocesi kundër mafias siçiliane “Cosa Nostra”.

Aktiviteti u publikua në rrjetin social dhe në faqen zyrtare të gjykatës në rubrikën **Pasqyra e Shtypit** datë 08.05.2024 me titull: **Aktiviteti me Gjimnazet: “Dhaskal Todri” Elbasan dhe “Ibrahim Muça” Librazhd** më datë 08.05.2024”.

2. Në kuadër të aktiviteteve për Javën e Drejtësisë në datë 10.05.2024 dhe 17.05.2024 u publikuan esetë e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Elbasanit me tematikë shkrimi i një eseje me **temë “Inkluzioni dhe të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar”**. Ky aktivitet, i konceptuar në zbatim të objektivave të përcaktuara në "Planin Strategjik të Komunikimit", në kuadër të "Javës së Drejtësisë", ka për qëllim njohjen, zhvillimin e njohurive, si edhe integrimin e të rinjve në fushën e së drejtës. Ftesa për bashkëpunim u dërgua në disa shkolla të mesme të qytetit të Elbasanit, në të cilën u përcaktuan dhe u referuan kornizat ligjore ndërkombëtare në mbështetje të Inkluzionit, bashkëlidhur u dërguan edhe pyetjet referenciale për ndërtimin e esesë bazuar në kuadrin ligjor referencial:

- 1948 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- 1960 Konventa kundër Diskriminimit në Arsim;
- 1989 Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- 1993 Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar;
- 1994 UNESCO Deklarata Salamanca;
- 2006 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Synimi ynë në realizimin e këtij aktiviteti është krijimi i ndërveprimit institucional dhe përhapja e njohurive në kuadrin ligjor tek fëmijët, aftësimi dhe njohja e tyre me të drejtat e tyre si edhe fëmijëve me aftësi të kufizuar, për këtë shkak esesë nuk iu përcaktua numri i fjalëve dhe u pranua çdo material i punuar prej tyre. Të gjithë materialet pas depozitimit u redaktuan nga Koordinatori për t'u përshtatur për publikim. Materialet u publikuan në dy përmbledhje më datë 10.05.2024 dhe 17.05.2024 në faqen zyrtare dhe në rrjetin social Facebook me titull: **Ese nga Shkollat e Mesme "Inkluzioni dhe të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar"**. Grupi (I) dhe (II). Shpresojmë të kemi përçarur kështu një ndërgjegjësim dhe një njohje më të mirë të kuadrit ligjor për këtë target grup. Ky aktivitet do të vijojë me një fazë të dytë certifikimi. Interesi dhe pjesëmarrja në këtë vit nga shkollat e mesme dhe numri i nxënësve ishte më i lartë se viti i

shkuar, çfarë tregon një interes aktiv në rritje të institucioneve arsimore por edhe vetë nxënësve të shkollave në angazhime dhe pjesëmarrje në aktivitete të tilla jo vetëm informuese, por edhe krijuese që ndihmojnë në rritjen e procesit të njohurive të tyre. Gjatë leximit dhe redaktimit të këtyre eseve vihet re një ndjeshmëri dhe sensibilizim i fëmijëve për grupet e marxhinalizuara të fëmijëve me aftësi ndryshe, që janë pjesë e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuar.

C. Në zbatim të objektivit Nr:5 i cili synon përforcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, në periudhën shtator-nëntor 2023 janë ndërmarre këto hapa verpimi:

1. Më datë 11.06.2024, gjyqtari i Seksionit Penal për të Mitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **z. Artur Prenga, pranoi ftesën e gazetares znj. Brunilda Kërcyku të televizionit Top Channel** për t'u intervistuar në lidhje me statistikën e publikuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me titull **“Statistika për të Dënuar të Mitur Vitet 2022-2023”** publikuar më datë 04.06.2024 në lidhjen si në vijim:
<https://gjykata.gov.al/.../gjykata-e-.../pasqyra-e-shtypit/>
Intervistën e dhënë për Top Channel nga gjyqtari z. Artur Prenga e gjeni të publikuar në lidhjen si në vijim:
<https://www.youtube.com/watch?si=S3qvP6moxKEFXduk...>
ose në faqen zyrtare të Top Channel. Minuta 14.21
<https://top-channel.tv/.../edicioni-informativ-13.../>
<https://top-channel.tv/.../te-miturit-me-pak-denime.../>
2. Duke mbajtur në konsideratën tonë të vazhdueshme se gjeneza e medias ka lindur pikërisht si kërkesë e publikut për të mësuar mbi dhe për pushtetin, si e tillë është jo vetëm një strukturë informuese për dhe mbi pushtetin, por edhe një strukturë plotësuese e kërkesave të publikut për të kontrolluar pushtetin. Ndaj, për ta ruajtur dhe strukturuar këtë formë të një rëndësie të veçantë për pasqyrim, Gjyqtari i Medias në koordinim me Gjyqtarët e çështjeve dhe Koordinatorin e të Drejtës së Informimit, ka mundur pjesëmarrje të vazhdueshme të medias për seanca gjyqësore për të cilat media ka shprehur interes.
3. I është kushtuar rëndësi maksimale pritjes së mediave në ambientet e gjykatës gjatë seancave për të cilat kanë shfaqur interes të ndiqen prej tyre. Gjithashtu në trajtimin e kërkesave të dërguara në postën elektronike kemi mbajtur standard të njëjtë trajtimi, pa ceduar në asnjë rast të biem në diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke treguar rigorozitet në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median **Neni 2/3. “Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me përfaqësues të caktuar të saj.”**

4. Në grupin e krijuar për mediat i cili u krijua me nismë të Gjyqtarit të Medias z. Ardit Kuka që gjithashtu monitoron këtë grup, kemi një numër të konsiderueshëm reporterësh të qytetit të Elbasanit dhe jo vetëm, si edhe synojmë përfshirjen jo vetëm të mediave lokale por edhe atyre kombëtare për përcjelljen në mënyrë periodike të informacionit pa kërkesë për çështje me interes të lartë publik, si dhe asistimin e kërkesave të medias në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase.
5. Ajo që vërejmë nga nisja për zbatim e Planit Strategjik të Komunikimit deri në këto momente është se ndërveprimi dhe trajtimi dinjitoz i përfaqësuesve të medias, mirëpritja dhe sigurimi i aksesit profesional në dhënien e informacionit të monitoruar nga Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka nëpërmjet koordinatorit, ka rezultuar në dhënien e një feedback-u pozitiv nga përfaqësuesit e mediave. Ndërveprimin me mediat ka qenë në rezultate të kënaqshme dhe të mirëpritura prej tyre. Kemi thjeshtuar format e kërkesës për marrje informacioni për seancat duke kërkuar prej tyre që kërkesat të përcillen në grup dhe jo të veçuara, meqenëse, secili prej tyre është tashmë i identifikuar nga ne për median për të cilën përcjell informacion.
6. Kemi ndjekur me interes dhe pa neglizhencë çdo raportim që lidhet me gjykatën dhe seancat për të cilat është raportuar në kohë reale.
7. Koordinatorin me udhëzim të Gjyqtarit të Medias z. Ardit Kuka, ka ndjekur çdo seancë gjyqësore në të cilën kanë qenë prezentë media duke siguruar akomodimin e tyre në seancë dhe duke ndjekur raportimet që bëhen për seancën, në mënyrë që të kemi mundësinë e një kontrolli real dhe të saktë të raportimeve që kryejnë reporterët në lidhje me informacionet që përcjellin për gjykatën nga një seancë gjyqësore. I gjithë procesi ndiqet në mënyrë aktive nga Gjyqtari i Medias z. Ardit Kuka duke e informuar përgjatë dhe pas procesit në lidhje me titujt dhe raportimet e kryera nga mediat në seancë.
8. Kontrollohet çdo ditë shtypi i ditës në lidhje me titujt e gazetave që lidhen me Gjykatën duke i referuar për vlerësim titujt Gjyqtarit të Medias.
9. Nuk kemi lejuar regjistrim të seancave gjyqësore në mungesë të plotësimit dhe paraqitjes së kërkesës 24 orë përpara seancës gjyqësore në zbatim të Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”.
10. Mirëmbajtja e faqes zyrtare me informacione që lidhen me aktet e njoftimit për palët, si edhe publikimi i materialeve për institucionet me të cilat ndërveprojmë, kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke respektuar afatet e publikimeve.

Jemi duke vijuar punën për realizime të tjera gjatë kësaj periudhe në përputhje me Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020.

Faleminderit
Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

